

VENDIMET E MBLEDHJES SË BORDIT 21 prill 2021

Vendimi Nr. 2021-030

Programi intensiv i ushtrimeve për National Teams

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimet e selektorëve që programi intensiv i ushtrimeve të vazhdojë sikur në fazën e parë për grupmoshën U16. Programi do të vazhdojë edhe për 5 muaj me ushtrime 3 herë në javë me nga dy orë dhe me trajner teknik Granit Bajraliu, trajner kondicional Fatos Bejta dhe 1 ndihmës trajner i cili do të ndërrohet me rotacion.
- Bordi me shumicë votash aprovon propozimet e selektorëve që për grupmoshën U14 dhe U12 të organizohen nga 3 kampe zhvillimore gjatë periudhës pranverë – vjeshtë 2021, me të paktën 5 ditë.
- Kampet do të udhëheqën nga selektorët Arian Ibrahimimi (U14), Lorik Haxhishabani (U12) si dhe ndihmës trajnerët që do të angazhohen.
- Pjesëmarrësit e programeve do të zgjedhen nga selektorët, ndërsa prindërit do të participojnë financiarisht me nga 25% nga kosotja totale.

Vendimi Nr. 2021-031

Fuzionimi i KT Kalaja në KT Prizreni

- Bordi me shumicë votash miraton propozimin për fuzionimin e KT Kalaja në KT Prizreni.
- Klubet do të bashkohen dhe zhvillojnë aktivitetet si një klub i vetëm nga fillimi i muajit maj 2021.

Vendimi Nr. 2021-032

Emërimin e një “Dizajner/e të Marketingut”

- Bordi merr vendim për hapjen e një pozite të rregullt pune me titull “Marketing person”, i/e cila do të angazhohet në menaxhimin e rrjeteve sociale të FTK-së.
- Detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet do të hartohen dhe aprovohen nga Bordi në ditët në vijim.

Vendimi Nr. 2021-033

Aplikimi për Grant nga Komuna për “Kamp Zhvillimor për grupmoshën U12/U14”

- Bordi me shumicë votash merr vendim të aplikohet për grant nga Komuna e Prishtinës me projekti “*Kamp Zhvillimor për U12/U14*” për të përfituar mbështetje financiare për realizmin e këtij aktiviteti.

Vendimi Nr. 2021-034

Referimi nga Blerata Ukëhaxhaj

- Bordi me shumicë votash merr vendim që Blerata Ukëhaxhaj të i lejohet referimi vetëm kur KRTK nuk ka alternativa të tjera dhe ka mungesë të referëve.
- Ky kusht do të vlejë vetëm për garat vendore, ndërkaq në garat e rangut ndërkombëtar pjesëmarrja e Bleartës në referim do të jetë e lejuar.

Vendimi Nr. 2021-035

Kontratat për administratën e FTK-së

- Bordi me shumicë votash aprovon kontratat e administratës për Sekretarën dhe Komisionerën me kushtet e specifikuara.

Vendimi Nr. 2021-036

Mëditjet (refer, trajner, zyrtar);

- Bordi me shumicë votash miraton ndryshimet në mëditje si në vijim:
 - o Barazim të mëditjeve tek të gjitha kategoritë me nga 40 EUR për ditë;
 - o Nese turneu nuk mbahet për çfardo arsyeje referit i paguhet gjysma e totalit të mëditjës për ditë, nëse gjendet në terrenet e tenisit, dhe nuk i paguhet fare mëditja nëse turneu anulohet një ditë më heret dhe referi nuk paraqitet në terrenet e tenisit.
 - o Rritje të mëditjeve për selektor / Ekip në gara / kampe të përfaqësueses (jashtë Kosovës) nga €40 në €50.
 - o Rritje të mëditjeve të trajnerëve në kampe në kampe përgaditore brenda Kosovës (
 - o >3h) nga €30 në €40;
 - o Rritje të mëditjeve të trajnerëve në kampe në kampe përgaditore brenda Kosovës (
 - o <3h) nga €15 në €20;
 - o Mëditjet në pjesëmarrje në kuvende, konferenca e seminare jashtë vendit €40;
 - o Angazhimet e Kryetarit në takime zyrtare €50 për ditë;



- Përkrahja financiare e selektorëve në shoqërimin e tenisteve në maksimum 2 turne rajonale brenda vitit. Mëditja për selektorët mbaron në momentin kur të gjithë lojtarët tanë kanë humbur meçet.